

**ANEKSI NR. 3 I LIGJIT NR. 147, DATË 17.12.2015 “PËR BUXHETIN E VITIT 2016”,
BOTUAR NË FLETOREN ZYRTARE NR. 236/2015**

**ANEKSI 3
FONDI PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE**

1. Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një instrument zhvillimor dhe një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe lokal, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohezionit territorial, për të pasur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

2. Për vitin 2016, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve përbëhet nga 3 shtylla:

2.1 Shtylla I: Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale Vendore

Ky Program përbëhet nga 6 grante konkurruese, specifikuar si më poshtë vijnë:

1. Granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale;
2. Grantet për arsimin:
 - a) Granti për arsimin bazë;
 - b) Granti për arsimin e mesëm;
 - c) Granti për arsimin universitar;
 - d) Granti për sportin.
3. Granti për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor);
4. Granti për artin dhe kulturën;
5. Granti për ujësjellës-kanalizime;
6. Granti për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzim.

Programet e **Shtyllës 1: Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale**, detajohen në aneksin 3/1, këtu bashkëlidhur.

2.2 Shtylla II: Programi i Mbështetjes për Ekonominë. Ky program përbëhet nga një grant konkurrues si më poshtë vijnë:

1. Granti për mbështetjen financiare për zhvillim ekonomik dhe nënprogramin e zhvillimit rajonal dhe lokal përmes mbështetjes së NVM-ve (Ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme)

Programet e **Shtyllës 2: Programi i Mbështetjes për Ekonominë**, detajohen në aneksin 3/2, këtu bashkëlidhur.

2.3 Shtylla III: Programi “Shqipëria dixhitale”. Ky program përbëhet nga një grant konkurrues, si më poshtë vijnë:

- a) Granti konkurues për “Shqipëria dixhitale”.

Programet e **Shtyllës 3: Programi “Shqipëria dixhitale”**, detajohet në aneksin 3/3, këtu bashkëlidhur.

3. Me qëllim përmbushjen e objektivave të politikës kombëtare për zhvillimin rajonal, Fondi për Zhvillimin e Rajoneve, përmes 3 Programeve (Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale, Programi për Mbështetjen për Ekonominë, Programi Shqipëria Dixhitale) mbështet projektet me ndikim në zhvillimin rajonal dhe lokal që:

a) Nxisin zhvillimin rajonal dhe lokal dhe ndikojnë në arritjen e objektivave të zhvillimit, kohezionit territorial dhe rritjes së konkurrueshmërisë së rajoneve tona;

b) Mbështesin krijimin dhe funksionimin e partneriteteve ndërvendore dhe rajonale midis vetë njësisve të qeverisjes vendore, dhe agjentëve të tjerë të zhvillimit, që ndikojnë në zhvillimin rajonal dhe lokal dhe arritjen e objektivave të kohezionit territorial dhe rritjes së konkurrueshmërisë së rajoneve tona;

c) Nxisin dhe mbështesin krijimin e partneriteteve, në nivelin rajonal dhe vendor, me natyrë ekonomike publike dhe private, në forma organizimi tregëtar, me qëllim shtimin e burimeve të investueshme, sidomos në ata sektorë që kanë prioritet për zhvillimin lokal dhe rajonal, dhe qëndrueshmërinë e investimeve e të projekteve përmes përbalueshmërisë financiare e kthimit;

ç) U ofrojnë asistencë (përmes mbështetjes për hartimin e projekteve-Facilitetit për Përgatitjen e Projekteve) agjentëve zhvillimore të interesuar për të hartuar e zbatuar projekte që mbështesin arritjen e objektivave të zhvillimit. Kuptimi dhe përcaktimi më i detajuar për “partneritetin rajonal” jepet në aktet nënligjore dhe/ose programet operacionale, për çdo shtyllë të Fondit, të cilat miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

4. Për të arritur objektivat e Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, mund të miratojë edhe nënprograme, që:

a) financojnë projekte dhe njësitë e qeverisjes vendore dhe shoqëritë e shërbimeve publike, sipas sistemit të financimit (granteve) me bazë rezultati dhe indikatorëve të përcaktuar për këtë qëllim. Rregulla më të hollësishme për këtë qëllim miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

b) financojnë projekte/pjesëmarrje me kthim, nën skemat e partneritetit rajonal në formën e një subjekti juridik privat dhe/ose agjenti zhvillimor në nivel lokal dhe/ose rajonal për investime në infrastrukturën vendore dhe rajonale me kthim (dhe/ose në formën e huamarrjes së brendshme, garancive, dhe investimeve me qëllime fitimi). Në këtë rast, rregulla më të hollësishme për skemat e financimit të projekteve me bazë partneriteti rajonal, në formën e një subjekti juridik privat dhe/ose agjenti zhvillimor në nivel lokal dhe/ose rajonal për investime në infrastrukturën vendore dhe rajonale, me kthim, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe zbatohen nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve.

5. Shpërndarja e financimit dhe menaxhimi i Fondit për Zhvillimin e Rajoneve kryhet nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, i cili kryesohet nga Kryeministri dhe ka këtë përbërje:

1. Kryeministrin	Kryetar
2. Zëvendëskryeministrin	Zëvendëskryetar;
3. Ministrin e Financave	anëtar;
4. Ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	anëtar
5. Ministrin e Zhvillimit Urban	anëtar;
6. Ministrin e Transportit dhe Infrastrukturës	anëtar;
7. Ministrin e Arsimit dhe Sportit	anëtar;
8. Ministrin e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	anëtar;
9. Ministrin e Shëndetësisë	anëtar;
10. Ministrin e Kulturës	anëtar;
11. Ministrin e Mjedisit	anëtar;
12. Ministrin e Punëve të Brendshme	anëtar;
13. Ministrin e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	anëtar;
14. Ministrin e Shtetit për Çështjet Vendore	anëtar;
15. Kryetarin e Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
16. Kryetarin e Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
17. Kryetarin e Shoqatës së Qarqeve	anëtar;

të Shqipërisë

18. Përfaqësuesin e Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal 1	anëtar;
19. Përfaqësuesin e Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal 2	anëtar;
20. Përfaqësuesin e Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal 3	anëtar;
21. Përfaqësuesin e Bordit të Agjencisë për Zhvillim Rajonal 4	anëtar;

6. Në mungesë të kryetarit të Komitetit, mbledhja drejtohet nga zëvendëskryetari. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve mbledhet, si rregull, minimalisht, një herë në dy muaj, me kërkesë të kryetarit.

7. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve, në kuadër të shpërndarjes së financimit dhe menaxhimit të Fondit, miraton, sipas shtyllave të përmendura më sipër:

a) programimin dhe shpërndarjen e financimit total, sipas akseve prioritare/drejtimeve prioritare të investimeve, që përbëjnë nënprogramet e programeve të shtyllave I, II dhe III, të përmendura në pikën 2 të këtij aneksi, përpara miratimit, në Këshillin e Ministrave, të projektbuxhetit për vitin pasardhës, me propozimin e Sekretariatit të Përgjithshëm;

b) dokumente strategjike lidhur me objektivat zhvillimorë të çdo programi, si dhe programimin e akseve prioritare/drejtimeve prioritare sipas nënprogrameve;

c) programin kombëtar operacional për zbatimin e Fondit sipas programeve të shtyllave I, II dhe III;

ç) specifikimet, formatet, rregullat dhe kriteret për financimin e projekteve dhe ndarjen e granteve, sipas propozimit të Sekretariatit të Përgjithshëm, bazuar në propozimet e sekretariateve teknike;

d) shpërndarjen e fondeve për financim për projekte të reja investimi, masën e financimit për projektet në vazhdim, si dhe nivelin e bashkëfinancimit/bashkëkontributit/ bashkë-pjesëmarrjes nga aplikuesit dhe/ose partneritetet rajonale dhe ndër-rajonale/ndër-vendore;

dh) rregulla të hollësishme lidhur me aplikimin, vlerësimin, menaxhimin e performancës si dhe të mbështetjes me grante mbi bazën e performancës, si dhe sistemet e raportimit e monitorimit (manuale, formate, kriteret e vlerësimit të projekteve, indikatorët e vlerësimit të performancës, formatet e hartimit të programeve operationale);

e) procese të tjera, që ndiqen në zbatim të pikave të këtij aneksi, për administrimin e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, performancën dhe arritjen e objektivave të programeve sipas shtyllave I, II dhe III.

8. Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është pranë Kryeministrit, si pjesë e Departamentit të Zhvillimit, Financimeve dhe Ndihmës së Huaj.

ANEKS 3/1

Shtylla I. Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale. Ky Program përbëhet nga 6 grante konkurruese, specifikuar si më poshtë vijojnë:

1. Financimi i programeve

A. Shtylla I: **Programi i Zhvillimit të Infrastrukturës Vendore dhe Rajonale**

Granti për infrastrukturën vendore dhe rajonale, ka burim financimi zërin “Shpenzimet për buxhetin vendor: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve”.

a) Grantet konkurruese për arsimin kanë burim financimi programet e mëposhtme buxhetore të Ministrisë së Arsimit:

i) Granti për arsimin bazë, me burim financimi programin e buxhetit “Arsimi bazë (përfshirë parashkollorin)”;

ii) Granti për arsimin e mesëm, me burim financimi programin e buxhetit “Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)”;

iii) Granti për arsimin universitar, me burim financimi programin e buxhetit “Arsimi Universitar”;

iv) Granti për sportin, me burim financimi programin e buxhetit “Mbështetje për sportin”;

b) Granti konkurrues për shëndetësinë (shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor) ka burim financimi programin e buxhetit “Shërbimet e kujdesit parësor”, të Ministrisë së Shëndetësisë;

c) Granti konkurrues për artin dhe kulturën ka burim financimi programin e buxhetit “Arti dhe Kultura”, të Ministrisë së Kulturës;

ç) Granti konkurrues për ujësjellës-kanalizime ka burim financimi programin e buxhetit “Furnizimi me ujë dhe kanalizime”, të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, si dhe grantin konkurrues për infrastrukturën vendore dhe rajonale¹;

d) Granti konkurrues për rehabilitim mjedisor, gjelbërim dhe pyllëzimin ka burim financimi programin e buxhetit “Administrimi i pyjeve”, të Ministrisë së Mjedisit.

2. Subjektet aplikuese dhe zbatuese (autoritetet kontraktore), përfituese të programeve të shtyllës I:

a) Aplikimi për financimin e projekteve nga fondet e programeve të shtyllës I, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, subjekte të kompetencave të përbashkëta të tyre, shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, agjencia kombëtare për zhvillimin rajonal, agjencitë për zhvillimin rajonal nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, partneritetet ndërvendore dhe rajonale, agentë zhvillimor në nivel lokal dhe/ose rajonal, dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit kur ka marrëveshje bashkëpunimi me bashkinë/bashkitë, Autoriteti kontraktues miratohet me vendim të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve.

b) Në rastet e projekteve me disa përfitues nën skemat e partneritetit ndërvendor dhe rajonal ose në raste të tjera të veçanta, marrëveshja e partneritetit midis përfituesve, cakton autoritetin kontraktor që i propozohet Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për miratim. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit, i cili mund të jetë njëri prej përfituesve, dhe/ose agjencia kombëtare për zhvillimin rajonal, dhe/ose agjencia për zhvillimin rajonal, dhe/ose Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe/ose agjenti zhvillimor në nivel lokal dhe/ose rajonal, përfaqësues i partneritetit ndërvendor dhe rajonal.

c) Zbatimi i projekteve të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është përgjegjësi parësore e autoriteteve kontraktuese, në bashkëpunim me përfituesit përkatës për çdo projekt, të cilët zbatojnë projektet, sipas rregullave dhe akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

ç) Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

3. Sekretariatet teknike

a) Sekretariatet teknike të programeve të shtyllës I ngrihen në ministritë përkatëse të linjës, si më poshtë vijon:

i) Sekretariati teknik për grantin për infrastrukturën vendore dhe rajonale, ngrihet pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban;

ii) Sekretariati teknik për grantet për arsimin, ngrihet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;

iii) Sekretariati teknik për grantin për shëndetësinë, ngrihet pranë Ministrisë së Shëndetësisë;

iv) Sekretariati teknik për grantin për artin dhe kulturën, ngrihet pranë Ministrisë së Kulturës;

v) Sekretariati teknik për grantin për ujësjellës-kanalizimet, ngrihet pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës;

vi) Sekretariati teknik për grantin për rehabilitim mjedisor, gjelbërimin dhe pyllëzimin ngrihet

¹ Për pikën 1/d më sipër, vetëm për financimin e prioritetit të ujit.

pranë Ministrisë së Mjedisit.

b) Rregulla të hollësishme për ngritjen, detyrat dhe funksionimin e sekretariatit teknik, si edhe rolin e institucioneve të tjera në procesin e programimit, financimit, zbatimit dhe monitorimit të fondeve dhe projekteve, sipas programeve të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

ANEKS 3/2

Shtylla II. Programi i Mbështetjes për Ekonominë dhe ka burim financimi zërin “Shpenzimet për buxhetin vendor: Fondi për Zhvillimin e Rajoneve”

1. Ky program përbëhet nga një skemë granti/instrumentat e financimit, si më poshtë vijojnë:

a) Granti për mbështetjen financiare për ekonominë rajonale, lokale (nënprogrami: financimi i pjesëmarrjes në shoqëri tregtare dhe instrumente të financimit për bizneset *start-up*) dhe nënprogrami i mbështetjes financiare për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të).

Rregulla më të hollësishme në lidhje me Programin e Mbështetjes për Ekonominë, format e financimit, përfituesit publikë dhe/ose privatë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

2. Subjektet aplikuese, përfitues/zbatuese të Programit të shtyllës II, vlerësimi paraprak i propozimeve dhe Sekretariati Teknik:

a) Aplikimi për fonde të shtyllës II, për nënprogramin e mbështetjes financiare bëhet nga njësitë vendore, partneritetet rajonale dhe ndërvendore (ndërkomunore), edhe në formën e shoqërive të përbashkëta tregtare me partneritet privat, agjencia për zhvillimin ekonomik rajonal për mbështetjen financiarë, ndërsa për nënprogramin e mbështetjes për NMV-të behët nga agjencia për zhvillimin ekonomik rajonal, si dhe autoriteti menaxhues i projekteve/nënprogramit të fondeve në mbështetje të NMV-ve.

b) Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve mund të vendosë financimin e skemave të grantit për nënprogramin e mbështetjes për NMV-të, me autoritet menaxhues agjencinë për zhvillimin ekonomik rajonal, me përfitues individë dhe subjekte private.

c) Autoriteti përfitues/zbatues/menaxhues për nënprogramin e mbështetjes financiare për NMV-të është agjencia për zhvillimin ekonomik rajonal. Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve miraton propozimin për financimin e nënprogramin të mbështetjes financiare për NMV-të, zbatimi i të cilit, si autoritet menaxhues ndaj palëve të treta (subjekteve private përfituese) bëhet nga agjencia për zhvillimin ekonomik rajonal.

ç) Projektet/nënprogramet për financim në kuadër të shtyllës II (të dyja nënprogramet), vlerësohen për efektshmërinë ekonomike dhe kthyeshmërinë e vlerës së mbështetjes financiare nga Bordi i Këshillimit (i cili ka në përbërje përfaqësues edhe nga partnerët e huaj të zhvillimit dhe organizata private, sipas aktit të krijimit të agjencisë për zhvillimin rajonal), pranë agjencisë për zhvillimin ekonomik rajonal. Agjencia për zhvillimin ekonomik rajonal luan rolin e Sekretariatit Teknik të Programit të shtyllës II, si dhe të autoritetit menaxhues të nënprogramit për mbështetjen e NMV-ve, bazuar në vlerësimin paraprak të Bordit të Këshillimit.

d) Zbatimi i projekteve të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është përgjegjësi parësore e autoriteteve përfitues/zbatues/menaxhues si më lart, në bashkëpunim me përfituesit përkatës për çdo projekt, të cilat zbatojnë projektet dhe financimin përkatës me përpikëri, sipas rregullave dhe akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

dh) Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese, mira-tohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

e) Rregulla të hollësishme për ngritjen, detyrat dhe funksionimin e sekretariatit teknik, si edhe rolin e institucioneve të tjera në procesin e programimit, financimit, zbatimit dhe monitorimit të

fondeve dhe projekteve, sipas Programeve të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

ANEKS 3/3

Shtylla III. Programi “Shqipëria dixhitale” (inovacioni dhe teknologjia e informacionit dhe komunikimit).

1. Financimi i programit

Fondi për programin “Shqipëria dixhitale” përbëhet nga granti konkurrues për inovacionin dhe teknologjinë e komunikimit, me burim financimi zërin “Shpenzimet për buxhetin vendor: Fondi i për Zhvillimin e Rajoneve”.

2. Subjektet aplikuese dhe zbatuese, përfituese të programit të shtyllës III:

a) Aplikimi për fonde të shtyllës III bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore e partneritetet rajonale, dhe/ose agjencia kombëtare për zhvillimin rajonal, dhe/ose agjencitë për zhvillimin rajonal nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, dhe /ose agjencia për zhvillimin ekonomik rajonal sipas marrëveshjes së partneritetit në rastin e partneriteteve rajonale dhe ndërvendore dhe/ose Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për projekte me shumë përfitues, kur ka marrëveshje bashkëpunimi me bashkitë. Autoriteti kontraktues miratohet me vendim të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve.

b) Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve mund të vendosë financimin e skemave të grantit për inovacionin, nga programi “Shqipëria dixhitale”, me përfitues individë dhe subjekte private. Në këtë rast, rregulla më të hollësishme për skemat e grantit për inovacionin përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe zbatohen nga Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve.

c) Në rastet e projekteve me disa përfitues nën skemat e partneritetit ndërvendor dhe rajonal ose edhe në raste të tjera të veçanta, marrëveshja e partneritetit ose e projektit me shumë përfitues përcakton autoritetin kontraktor që i propozohet Komitetit për miratim. Komiteti miraton me vendim autoritetin kontraktor për zbatimin e projektit, i cili mund të jetë edhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe/ose njëri prej përfituesve, kur ka marrëveshje bashkëpunimi midis tyre dhe partnerëve/përfituesve.

d) Zbatimi i projekteve të miratuara me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve është përgjegjësi parësore e autoriteteve kontraktuese, në bashkëpunim me përfituesit përkatës për çdo projekt, të cilat zbatojnë projektet me përpikëri, sipas rregullave dhe akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

e) Rregulla të hollësishme lidhur me raportimin e autoriteteve kontraktuese, miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.

3. Sekretariati teknik:

a) Sekretariati teknik për grantin konkurrues për programin “Shqipëria dixhitale” ngrihet pranë ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

b) Rregulla të hollësishme për ngritjen, detyrat dhe funksionimin e sekretariatit teknik, si edhe rolin e institucioneve të tjera në procesin e programimit, financimit, zbatimit dhe monitorimit të fondeve dhe projekteve, sipas Programeve të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, miratohen me vendim të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.